



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë .2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.100, DATË 05.08.2026, "PËR
MIRATIMIN E MOSHËS DHE KRITEREVE TË REGJISTRIMIT NË ÇERDHE
ERSEKË".**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 23 pika 12, nenit 54, shkronja "k", të Ligjit Nr. 139 /2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 21, neni 28 pika 2, neni 28 pika 4, të ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit nr.662 datë 8.10.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike", pika 2 e vendimit 632, datë 04.10.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar". Urdhri Nr. 76/1, datë 24.01.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijet 0-6 vjeç", i ndryshuar me Urdhër Nr.457, datë 13.06.2018 për hapjen e kopshtit me drekë në godinën e kopshtit ekzistues "Afërdita Kole" Ersekë, vendimin nr. 20, datë 17.07.2025 "Për disa ndryshime në vendimin nr.90, datë 31.08.2023 "Për miratimin e funksionit të kopshtit me drekë në godinën e kopshtit nr.1 Afërdita Kole, Ersekë, në godinën e kopshtit nr. 2 "Marie Gjergo", Ersekë". Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, i kërkon Këshillit Bashkiak të miratojë në mbledhjen e datës _____:

PROPOZOI:

1. Te miratojë moshën e pranimit në çerdhe nga 1 – 3 vjeç, përjashtuar fëmijët të cilët nuk kanë mbushur një vjeç.
2. Të drejtën e regjistrimit e kanë të gjitha familjet pa përjashtim, fëmijët e të cilëve plotësojnë kriterin moshë.
3. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Drejtoria e Edukimit dhe Zhvillimit të Fëmijëve dhe administrata e Bashkisë Kolonjë.
4. Ky projekt- vendim bën ne fuqi pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konc: Drejtori D.SH.S.Z.H.E.F.A. Dake
Konfirmoi: Drejtori D.C.J.P.O.Life

KRYETARI
ERSON ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 5429 prot.

Datë 21.8.2026

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. _____ Datë _____ / _____ /2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.100, DATË 05.08.2026, "PËR
MIRATIMIN E MOSHËS DHE KRITEREVE TË REGJISTRIMIT NË ÇERDHE
ERSEKË".**

Të nderuar!

Në mbështetje të nenit 8, nenit 23 pika 12, nenit 54, shkronja "k", të Ligjit Nr. 139 /2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 21, neni 28 pika 2, nenit 28 pika 4, të ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit nr.662 datë 8.10.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike", pika 2 e vendimit 632, datë 04.10.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar". Urdhri Nr. 76/1, datë 24.01.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijet 0-6 vjeç", i ndryshuar me Urdhër Nr.457, datë 13.06.2018 për hapjen e kopshtit me drekë në godinën e kopshtit ekzistues "Afërdita Kole" Ersekë, vendimin nr. 20, datë 17.07.2025 "Për disa ndryshime në vendimin nr.90, datë 31.08.2023 "Për miratimin e funksionit të kopshtit me drekë në godinën e kopshtit nr.1 Afërdita Kole, Ersekë, në godinën e kopshtit nr. 2 "Marie Gjergo", Ersekë". Në Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, ju informojmë:

-Çerdhja e qytetit funksionon prej 4 vitesh. Ambientet e çerdhes janë vendosur në godinën e kopshtit nr.2 "Marie Gjergo". Çerdhja ofron shërbime për fëmijët e grupmoshës 1-3 vjeç.

Duke parë numrin e kërkesave për regjistrim nga kjo grupmoshë, kapacitetin akomodues të ambienteve të institucionit, i cili është i plotësuar me fëmijë të cilët do përfitojnë, kapacitetin e edukatorëve, mungesa e mjekut/infermierit të cilët nuk plotësojnë kushtet për kujdesin e fëmijëve deri 12 muaj. Nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve është parë e

arsyeshme që fëmijët pa mbushur moshën 1 vjeç nuk mund të regjistrohen në çerdhe, pasi kjo grupmoshë kërkon kujdes të shtuar, referuar kapaciteteve të ambientit dhe edukatorëve nuk shihet e mundshme ofrimi i shërbimit për këta fëmijë.

Në lidhje me këtë projekt-vendim është bërë dhe konsultim publik me prani të prindërve të interesuar ku janë shpalosur të gjitha kërkesat dhe mendimet nga të dy palët.

Nëpërmjet këtij projekt-vendimi vendoset mosha e pranimi në çerdhe, për të bërë të mundur pranimin e kërkesave të paraqitura për përfitim, në bazë të kriterit moshë. Dokumentacioni për regjistrimin e fëmijëve dorëzohet pranë drejtorit të Çerdhes, në godinën e Kopshtit Nr. 2, "Marie Gjergo", Ersekë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Konc: Drejtori D.SH.S.ZH.F.F.E. Dake
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P. O Lifo

